



**NGRITJA  
E ZËRIT**

**Tel:** 044 195-113  
044 633-325  
**Adresa:** Rruga e UÇK-së,  
Skenderaj  
**Email:** info@ngritjaezerit.org  
**Web:** www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

**PADITES:** Avdyl Durmishi nga fshati Rakinicë, 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

**E PADITUR:** REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës  
nr.11 11000 Beograd

### **PADI PER KOMPENZIM DEMI**

**Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale** ( sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

**Objekt kontesti :** Kompensimi dëmit

**Vlera e kontestit :** 247 000 €

1.) Paditësi se bashku me familjen 7 anëtarësh gjatë luftës së viteve 1998-1999, është detyruar ta braktisë shtëpinë si rezultat i presioneve nga forcat paramilitare dhe paramilitare të udhëhequra direkt nga Qeveria e Serbisë .

2.) Provë :

- Kërkesa nr.580- 98 e datës 28 janar 200

- Deklarata për bashkësinë familjare sipas numrit rendor 035/2359 e datës 28 janar 2009

2.) Paditësi me anëtarët e familjës është pronar i sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme të cilat janë krijuar nga puna e përbashkët dhe trashëgimia , kjo patundshmëri përbehet prej shtëpisë me sipërfaqe prej 117 m<sup>2</sup> , të djegur dhe shkatërruar tersisht, duke përfshirë teknikën e bardhe dhe mobilerinë e 5 dhomave të gjumit, pastaj stallën me dimensione 50 m<sup>2</sup> dhe bagëti të vrara; dy lopëve me dy vjeta si dhe i është plaçkitur Traktori IMT 533 , viti i prodhimit 1976 së bashku me rimorkion .

Provë : - Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-72015060-00010 e dt. 23 janar 2009

- Vërtetimi i Drejtorisë për Urbanizëm nr.325-110 i datës 23.01.2009

- Dëgjimi i paditësit dhe deshmitarve të propozuar si dhe provave të tjera të cilat paditësi do të prezantoj në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës

3.) Viktimës nga forcat ushtarake policore serbe të udhëhequra direkt prej qeverisë së Serbisë e cila ka kryer veprime gjenocidiale , krime kundër njerëzimit, i është shkatërruar pasuria , është detyruar ta braktisë vendbanimin se bashku me fëmijët në kohë zgjatje prej 10 muaj e 18 ditë.

4.) Të drejtën për kompensim padisi e bazon në nenin 185 të LMD ( G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78 ) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qenë e obliguar të pengoj aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë së paditësit .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut ( neni 1 Protokoll nr. 1 , neni 2 dhe protokoll nr. 6 , neni 3 , neni 5 ( 5 ) , neni 10 dhe neni 14 ) .

Paditësi propozon që kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bjen këtë :

#### AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesa paditëse e Avdyll Durmishi me vendbanim në Rakinicë , 41000 Skenderaj Republika e Kosovës, në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë - Qeveria e R.S. si pasardhëse juridike e Qeverisë së mëparshme që në emër të të njëjtës të kompensojë demin material dhe jo material paditësit Avdyll Durmishit me vendbanim në fshatin Rakinicë, 41000 Skenderaj Republika e Kosovës, duke ja paguar;

- shumen prej 58 800 € për dhembjen shpirtërore dhe të munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi në qiell të hapur dhe shtëpi të huaja gjatë periudhës kohore prej 7 muaj e 1 javë
- shumen prej 50 000 € për shkak të pamundësuarit e krenimit të festave fetare në shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes së kontaktit me farefis dhe të afërmit
- shumen prej 120 000 € për shtëpinë të djegur dhe të shkatërruar tërësisht.
- shumen prej 10 000 € për teknikën e bardhe në sallën mobilerinë e 5 dhomave të gjumit
- shumen prej 8 200 € në emër të shkatërrimit të traktorit të tipit IMT 533 me rimorkio të re dhe vrasjen e dy lopëve dhe dy vjetëve
- shumen prej \_\_\_\_\_ € për pamundësimin e shfrytëzimit të tokës bujqësore për tri vite.

te gjitha këto shuma me kamatë ligjore që nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm .

Pala e paditur të paguaj shpenzimet procedurale të kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm .

1.) të bihet :


#### AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit të paditëses në tërësi çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marrë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike të paditëses në kuptim të nenin të Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi

Avdyll Durmishi



Shtojcë :

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës nr.580- 98 e datës 28 janar 2009
2. Deklarata për bashkësinë familjare sipas numrit rendor 035/2359 e datës 28 janar 2009
3. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL – 72015060-00010 e dt. 23 janar 2009
4. Vërteimi nga Drejtoria e Urbanizimit nr. nr.325-110 i datës 23.01.2009
5. 4 kopje të padisë nr.325-110 i datës 23.01.2009